



## Informimi javor për median Dhomat dhe Zyra Administrative

N°20/2022

Hagë, 26/05/2022

### Përditësim

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'ju ofrojmë gazetarëve një përditësim mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë, informacion për javën e ardhshme dhe mundësinë për të drejtuar pyetje.

Në gjykimin kundër Hashim Thaçit dhe të bashkakuzuarve, më 20 maj Paneli i Gjykatës së Apelit vendosi lidhur me apelet nga z. Thaçi dhe z. Veseli kundër “Vendimit mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime ndaj Ligjshmërisë së DHS-së dhe ZPS-së dhe Shkeljen e Pretenduar të Disa të Drejtave Kushtetuese të të Akuzuarve” të Gjykatësit të Procedurës Paraprake. Paneli i Apelit i rrëzoi apelet dhe konfirmoi konstatimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake se nuk ka asnjë gabim në lidhje me mandatin kohor të Dhomave të Specializuara dhe se nuk ka pasur asnjë shkelje të drejtave kushtetuese të të akuzuarve.

Në të njëjtën çështje, Gjykatësi i Procedurës Paraprake në konferencën për ecurinë e çështjes të mbajtur më 20 maj, nxori një numër urdhrash gojorë. Ai caktoi datën 30 qershor 2022 si afatin e fundit për Zyrën e Prokurorit që të përfundojë nxjerrjen e materialeve të mundshme shfajësuese të marra pas janarit 2022 si dhe për dorëzimin e çdo kërkesë për masa mbrojtëse, sipas rastit.

Gjykatësi i Procedurës Paraprake më tej caktoi 30 shtatorin 2022 si afatin e fundit për ZPS-në që të përfundojë procesin e nxjerrjes së materialeve sa i përket kërkesave të Mbrojtjes për materiale dhe prova në zotërim të ZPS-së që ZPS-ja nuk synon t'i përdorë në gjykim.

Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëroi ekipet e Mbrojtjes, nëse dëshironin, të dorëzonin dosjet e tyre paraprake, brenda të premtes, 21 tetor 2022.

Më 25 maj 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori vendimin e tretë lidhur me pjesëmarrjen e viktimave në këtë çështje. Dymbëdhjetë parashtrues të rinj u pranuan

1





## Informimi javor për median Dhomat dhe Zyra Administrative

N°20/2022

Hagë, 26/05/2022

si viktimat pjesëmarrëse në proces, të cilët do t'i shtohen grupit ekzistues prej 20 viktimash pjesëmarrëse dhe do të përfaqësohen nga i njëjti mbrojtës viktimash.

Në të njëjtën çështje, dje u bënë publike versionet e redaktuara publike të vendimeve më të fundit të Gjykatës të Procedurës Paraprake lidhur me rishikimin e paraburgimit të Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit. Në të dyja vendimet, të nxjerra me 13 maj, urdhërohej vazhdimi i paraburgimit të të akuzuarve dhe theksohej rreziku i pengimit të ecurisë së procesit ose kryerjes së krimeve të tjera.

Gjithashtu, Gjykatësi konstatoi se këto rreziqe mund të zvogëlohen vetëm me anë të zbatimit të kornizës për monitorimin e komunikimeve që përdoret në objektin e paraburgimit të DHS-së.

Më 20 maj, Trupi Gjykses I urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të z. Salih Mustafa. Trupi Gjykses vlerësoi se ekziston ende rreziku që i akuzuari të pengojë ecurinë e procesit në rast se lirohet, për shkak të përvojës së tij në zbulim, kontakteve që ka si dhe duke mbajtur parasysh atmosferën e përgjithshme të frikësimit të dëshmitarëve.

Versionet e redaktuara publike të tre vendimeve më të fundit për rishikimin e paraburgimit mund të gjenden në faqen e internetit të Dhomave të Specializuara të Kosovës.

Në çështjen kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt, Kryetare Ekaterina Trendafilova më 24 maj caktoi Panelin e Gjykatës së Apelit për të trajtuar kërkesën e Mbrojtjes së Haradinajt lidhur me qartësimin e afatit për dorëzimin e apelit kundër Aktgjykimit. Mbrojtja kërkon që afati për dorëzimin e apelit të jetë 30 ditë pas marrjes së përkthimit të Aktgjykimit në shqipe dhe jo 30 ditë pas shpalljes së Aktgjykimit, sikurse është parashikuar në rregullën 176(2) të Rregullores së Procedurës dhe Provave.





## Informimi javor për median Dhomat dhe Zyra Administrative

N°20/2022

Hagë, 26/05/2022

Paneli i Apelit, i përbërë nga gjykatësit Mishelë Pikard, Kai Ambos dhe Nina Jorgensen, e nxori vendimin me 25 maj. Në vendim Paneli pranon rëndësinë e të drejtës së të akuzuarve që të marrin Aktgjykimin në një gjuhë që e kuptojnë, por në të njëjtën kohë vlerëson se drejtësia e procesit në këtë fazë nuk do të ndikohet negativisht nga mungesa e përkthimit në fjalë. Për këtë arsye, Paneli konstaton se palët duhet të dorëzojnë njoftimin për apel, nëse kanë, brenda afatit të përcaktuar në rregullën 176(2) të Rregullores, konkretisht brenda të premtës, 17 qershor 2022.

### Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje

